REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
KRYETARI

Nr.2073 Prot.

Bilisht më, 13.06.2022

URDHËR

Nr.175 Date 13.06.2022

PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR REKOMANDIMET E LËNA NGA KLSH

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 41, neni 64, pika gj, Ligjit nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", raportit të auditimit nga KLSH me nr.50/9 datë 23.05.2022 "Mbi rekomandimet e KLSH".

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit të veprimit sipas rekomandimeve nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.
2. Raportimin pranë Zv.Kryetarëve brenda datave 20.09.2022 dhe 01.11.2022.
3. Ngarkohen të gjithë sektoret për marrjen e masave dhe nxjerjen e akteve në zbatim të detyrave.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Adresa:Bashkia Devoll,Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9,Tel& Fax +35581123815-22288, e-mail bashkiadevoll@gmail.com.ëeb.http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL

Adresa:Bilisht

Nr. 908/9 Prot.

Bilisht më 3/06/2022

PROGRAMI (PLAN - VEPRIMI)
PËR
ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË KLSH, DËRGUAR ME SHKRESËN E KLSH NR. 50/9 DATË 23.05.2022 , " DËRGOHET RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT DHE REKOMANDIMET"

Bazuar në nenin 30/pika 2 e ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për caktimin e afateve dhe personave përgjegjës, në lidhje me realizimin dhe raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, dërguar në Bashkinë Devoll, me shkresën e KLSH, nr.50/9 datë 23.05.2022 brenda afatit prej 20 ditës dhe afatin prej 6 muaj nga data e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, hartohet Programi (Plani i Veprimit) për realizimin e rekomandimeve të KLSH si më poshtë:

ANEKSI NR.1

Nr	Num Rekom sipas Shkre KLSH	PËRMBAJTJA E REKOMANDIMIT TË KLSH	Rekomanduar nga KLSH. Shpërblimi i dëmit ekonomik, apo efekti financiar ekonomik, pa dëm ekonomik (Ne lekë)	Referen e Faqes dhe paragrafit ne Raportin Perfundimtar	Reagimi (Menaxh imit) i subjektit te audituar (Pranuar ose , nuk pranohen	Afati i zbatimit sipas rekomandimit te KLSH apo Subjektit te audituar	Emri Mbiemri i personit te ngarkuar me ndjekjen dhe raportimin e zbatimit rekomandim	Pozicion i Punës Nëpunësit sipas structure, ne organike
a	b	c	1	2	3	4	5	6
		A. MASA ORGANIZATIVE(Gjithsejt)						
1	1	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e	**Ska**	29-32	Pranuar	Ne vijimesi	Eduard Duro	Kryetar Bashkie

		sistemit të MFK, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë deri diku mirë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion është duke shkuar drejt një konsolidimi të plotë, por nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Rregullorja e Brendshme ka një konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar edhe kompetencave e akteve nënligjore në fuqi. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si: - Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen. - Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm. - nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. - Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme - Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij **1.1. Rekomandimi:** Nga Titullari i Bashkisë Devoll, të marren masa për: -Hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.					Eliverta Pavliqoti Zerina Sinani Adriana Rushitaj Enida Haxhija	Zv.Kryetar Zv.Kryetar Pergjegjese e Sektorit te Burimeve Njerezore Pergjegjese e zyres juridike, prokurimeve

		- Kryerjen e investimeve në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. - Zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. - Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë. - Përditësimin e Rregullores së Brendshme e Bashkisë Devoll, duke përcaktuar qartë mënyrat menaxheriale dhe përshkrimet e detyrave për çdo vend pune, përgjegjësit e punonjësve, si dhe raportimi i tyre ne mënyrë periodike. - Plotësimin e vendeve vakante të pozicioneve të larta drejtuese në bashki sipas organikës së miratuar, kjo për një menaxhim më të mirë të veprimtarisë së menaxhimit financiar e kontrollit në këtë bashki.						
2	2	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitu nga Njësia e Auditit të Brendshëm (NJAB), rezulton se: - Organizimi i NJAB- Bashkia Devoll, nuk është në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", si dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", me emërtesën "Njësia e Auditimit të Brendshëm", pasi nga 3 Auditues të përcaktuar për të qene pjesë e njësisë, janë dy dhe nuk ka as përgjegjës. - Nga drejtuesja e NjAB, nuk është kryer sigurimi i cilësisë së punës. - Disa nga subjektet e audituara, pavarësisht se kanë	Ska	32-37	Pranuar	Menjehere dhe ne vijimesi	Anida Kaso Eduard Shaholli	Specialiste te auditi tte Brendeshe m

		pranuar rekomandimet e lëna, ato nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimit. - NjAB, pavarësisht planifikimit, nuk ka kryer angazhimin për auditim të Drejtorisë së Financës, Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, apo të planifikojë auditimin e procedurave të prokurimit pranë AK, Bashkia Devoll dhe Njësitë Administrative të saj. - Nuk është kryer auditim në zonat me risk të lartë, si: prokurimet me vlerë të vogël dhe vlerë të lartë, lejet zhvillimore të lëshuara nga Sektori i PLZHT *(taksën e ndikimit ne infrastrukturë)*, shpenzimet operative (art. 602), për të gjitha llojet e blerjeve, administrim-menaxhim i Aseteve pronë e bashkisë nuk janë zhvilluar auditime të thelluara, zbatimi i kontratave të punimeve dhe shërbimeve, menaxhimi i borxhit tatimore dhe rritja nga njëra periudhë në tjetrën, nuk është hartuar regjistri i riskut, etj, veprime në kundërshtim me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm ne sektorin publik"; Manuali i auditimit miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimi e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik" Kap. VII, pika 7; VKM nr. 83, datë 03.02.2016" Për Miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"; neni 11 i VKM nr. 114/2015 datë 22.10.2015"Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik"; Standartet e Auditimit; -Rregulloren e brendshme te Bashkisë Devoll miratuar nga Kryetari i Bashkisë **2.1 Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm (NJAB) Bashkia Devoll, të kryejë monitorimi në zbatimit të rekomandimeve, si dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit Auditit të Brendshëm.						

		2.2 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrin masa për plotësimin e strukturës me Përgjegjës Sektori për një menaxhim më të mitë të punëve. **2.3 Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm, të marrë masa që të sigurojë paraqitjen në mënyrë periodike para menaxhimit dhe Këshillit Bashkiak të raporteve të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditimit, në mënyrë që të realizojë misionin e saj, ku veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari e pavarur, që mbështet menaxhimin e njësisë vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.					Adriana Rushitaj	Pergjegjese e Sektorit te Burimeve Njerezore
3	3	**Gjetje nga auditimi:** Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Devoll dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxhetet vjetore gjatë viteve kanë pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Devoll. Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB. Kështu për *në vitin 2020,* kanë ndodhur 6 ndryshime me vlerë 800,718 mijë lekë, *në vitin 2021* kanë ndodhur 6 ndryshime me vlerë 114,493 mijë lekë, veprime që tregojnë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke	Ska	37-52	Pranuar	Menjehere dhe ne vijimesi	Aurela Furxhi	Pergjegjese e Sektorit te Planifikimit te Buxhetit

		e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit*" i ndryshuar, pikat 253 dhe 354 **3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhetit në bashkëpunim me Sektorët e tjerë në Bashkinë Devoll, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.						
4	4	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me realizmin e investimeve publike, rezulton se, për vitin 2020 ky nivel paraqitet në masën 31.3%, ku nga vlera planifikuar prej 63,544 mijë lekë është realizuar vlera prej 19,892 mijë lekë. Ndërsa në vitin 2021është realizuar në masën 54 %, ku nga vlera planifikuar prej 74,619 mijë lekë është realizuar vlera prej 40,584 mijë lekë. Kjo situatë vjen si rezultat i planifikim të procedurave pa fonde në dispozicion, në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (*investime/ shërbime/blerje malli*), në raport me nivelin e planifikimit të të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre, nivel ky i cili nuk kalon limitet e 50% për asnjërin nga vitet objekt auditimi. Gjithashtu, bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor), si dhe nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të	Ska	37-52	Pranuar	Menjehere dhe ne vijimesi	Aurela Furxhi	Pergjegjese e Sektorit te Planifikimit te Buxhetit

		kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore, ku për vitin 2020 ato janë në shumën 57,268 mijë lekë, në fund të vitit 2021 në shumën 51,630 mijë lekë. Veprime në kundërshtim me nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimi të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*" me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*"; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9,datë 20.03.2018 "*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*" me ndryshime, si dhe pika 1 e nenit 4 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar **4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet. **4.2. Rekomandimi:** Planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizmit të të ardhurave dhe jo të planifikimit të tyre, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (*faturave të palikujduara*), në fund të periudhave ushtrimore, duke planifikuar ato që kanë të bëjnë me shërbimet dhe investimet më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Devoll. **4.3. Rekomandimi:** Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim efiçent i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.						

5	5	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave KLSH-ja konstaton se për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa mbi afatin **30 ditor** të faturave për shpenzime/ shërbime/investime të mbërritura në institucion në **273** raste në vlerën **193,664 mijë** lekë nga e cila: për vitin 2020 janë **125** fatura me vlerë **106,273mijë** lekë dhe për vitin 2021 janë **148** fatura me vlerë **87,391mijë** lekë. Ky fenomen vjen nga mosrealizim i të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26/06/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52. Gjithashtu nga Bashkia Devoll (*Drejtoria e Financë/Buxhet*), evidentohen dhe fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre kjo për efekt të mungesës së fondeve nga realizmi i të ardhurave vendore. Kështu për periudhën objekt auditimi 01/01/2020 – 31/12/2021, paraqiten gjithsej **5** fatura me vlerë **15,248 mijë** lekë **5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës *(përjashtuar kufizimet e MFE)*,për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikujduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.	**Ska**	37-52	Pranuar	Menjehere dhe ne vijimesi	Matilda Hoxha	Pergjejgese e Sektorit te Menaxhimit Financiar
6	6	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se kontratat nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara në buxhetet respektive por në periudha të mëvonshme, kjo si rezultat i mos alokimi të fondeve nga Ministritë e linjës dhe për pjesën e Bashkisë Devoll nga mos realizmi i të ardhurave nga taksat/ tarifat vendore. Nga auditimi i të dhënave, rezulton se fondet e akorduara nga Ministritë e linjës nuk janë të planifikuara në vlerën e plotë në momentin e kryerjes së procedurës, por janë të ndara në periudha, ku për vitin e parë nuk është respektuar	**Ska**	37-52	Pranuar	Menjehere dhe ne vijimesi	Aurela Furxhi Gazmend Haxhija	Pergjegjese e Sektorit te Planifikimit te Buxhetit Drejtor i drejtorise se te Ardhurave dhe Licensimit

		kufiri 20% i vlerës së fondit limit. Ndërsa në lidhje me zbatimin e procedurave me fondet e vetë Bashkisë Devoll për vitin 2020-2021 dhe grandeve të qeverisë, mos likujdimi i kontratave nuk vjen nga ndarja me vite të financimit, por nga mos realizimi i të ardhurave nga taksat/tarifat vendore dhe planifikimi i procedurave pa një studim të mirëfilltë. Në planifikimin e procedurave për vitet vijuese Bashkia Devoll (Sektori i buxhetit), nuk merr në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave nga taksat/tarifat vendore, ku niveli i tyre nuk kalon 70%, nuk ka në konsideratë nevojën për fonde në likuidimin e detyrimeve të prapambetura të cilat janë në vlera të larta. Veprime këto në kundërshtim me nenin 40 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimi të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"; nenet 79 -80-81, të udhëzimit të MFE nr.9,datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" me ndryshime *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)* **6.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Devoll, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara. **6.2. Rekomandimi:** Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim efiçent i					GMS	

		burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. 6.3. **Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim i plotë në kontabilitet.						
7	7	**Gjetje nga auditimi:** Bashkia Devoll për vitet buxhetore 2020 dhe 2021, ka planifikuar të ardhurat e veta **në vlera jo reale dhe të pa argumentuara**, pasi ka një rritje artificiale të planit të të ardhurave, fenomen që vihet re edhe nga realizmi i tyre **në nivele jo të mira.** Nisur nga ky fenomen gjatë planifikimit të buxheteve vjetore 2020 dhe 2021, Bashkia Devoll ka planifikuar të kryejë shpenzime kapitale dhe korrente bazuar mbi transfertës e pakushtëzuar dhe planit të të ardhurave jo real. Për rrjedhojë konstatohet një përqindje shumë e ulët e realizimit të investimeve të planifikuar, pasi fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit (transf.e pakushtëzuar), përdoret për mbulimin e fondit të pagave dhe sigurimeve në masën rreth 90% duke qenë se në Bashkinë Devoll rezulton një strukturë e organikës me numër të lartë punonjësish, tendencë kjo që ka ardhur në rritje nga viti në vit. Në këto kushte Bashkia Devoll, për realizimin e investimeve të planifikuara është detyruar që për kontratat e lidhura për vitet 2020-2021 me burim financimi të ardhurat e veta, ngurtësimin e fondeve e ka shpërndarë në 3 vitet buxhetore në kundërshtim me ligjin për Buxhet si dhe për vitin e parë të financimit të këtyre kontratave nuk është respektuar limiti 20% e vlerës së kontratës duke treguar angazhim pa fonde në dispozicion. Pesha kryesore e financimit të kontratave me burim të ardhurat e veta bie mbi vitin e tretë të financimit rreth 80%	Ska	37-52	Pranuar	Menjehere dhe ne vijimesi	Eduard Duro Aurela Furxhi GMS	Kryetar i Bashkise Pergjegjese e Sektorit te Planifikimit te Buxhetit

		e vlerës totale. Për sa më sipër nisur edhe nga fakti i realizimit të ulët të të ardhurave si dhe nga stoku i detyrimeve aktual në shumën **51,630 mijë lekë** projeksioni mbi vitet pasardhëse 2022 dhe 2023 për shpenzimet që duhet të kryejë për kontratat kryesore me burim financimi të ardhurat e veta është në shumën **146,482 mijë lekë**, për rrjedhojë do të çojë në vështirësi financiare dhe pa aftësi paguese të kontratave të lidhura në vitet 2020 dhe 2021. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtimme nenet nr.50, nr.51 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar pikat 101 dhe 102 të udhëzimi të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"; nenet 65 79 -80-81-82, të udhëzimit të MFE nr.9,datë 20.03.2018 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit" me ndryshime . **7.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Devoll të marrë masa për rishikimin e strukturës së punonjësve dhe rritjes së numrit të organikës e pa nevojshme, si dhe të rishikojë kontratat e lidhura në vitet e mëparshme me burim financimi të ardhurat Bashkisë Devoll. **7.2. Rekomandimi:** Sektori i Buxhetit, të marrë masa që për investimet e reja me burim financimi me të ardhurat e bashkisë të mos kryejë copëzimin e fondeve për të shmangur detyrimet e prapambetura që çojnë në një situatë të vështirë financiare. **7.3. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Devoll, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme si dhe të hartojnë një plan për respektimin e disiplinës buxhetore për investimet kapitale.						

8	8	**Gjetje nga auditimi:** Nga analizimi i regjistrave të debitorëve në Bashkinë Devoll, konstatohet se vlera e debitorëve që rrjedhin nga detyrimet nga taksat dhe tarifat vendore për vitet objekt auditimi deri në 31.12.2020 nuk janë kontabilizuar. Vlera e debitorëve për subjektet fizik/ juridik (*vetëm nga taksat dhe tarifat që mblidhen nga Sektori i Taksave dhe të Ardhurave*) për vitin **2020** për subjektet juridike është në shumën prej **8,202,583 lekë**. Pra shihet qartë se sipas të dhënave nga regjistri për subjektet fizik/juridik për taksat dhe tarifat vendore në Drejtorinë eFinancës nuk janë kontabilizuar debitorët e ndryshëm, si dhe nuk ka rakordim midis Drejtorisë së shërbimeve financiare dhe buxhetit dhe Drejtorisë së të ardhurave, lejeve dhe licensave, për të kryer kontabilizimin e tyre dhe paraqitjen reale të llogarisë 486 "Debitorë të ndryshëm" duke mos e debituar këtë llogari. -Në analizë Gjobat e Inspektoriati të mbrojtjes së Territorit (IMT) Për vitin 2020 rezulton se nga Inspektoriati i mbrojtjes së territorit, janë vendosur masa për **23** subjekte fizik/juridik në shumën **8,350,000 lekë**. Nga ana e IMT-së Devoll lista e gjobave për vitin ushtrimor nuk i është dërguar me shkresë përcjellëse sektorit të financës për rrjedhojë kjo shumë është e pa kontabilizuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vitin 2020, në debi të llogarisë 468 "Kreditorë të ndryshëm". Veprime në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" , ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" **8.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet të marrë masa për të bërë sistemimet në	Ska	7-109	Pranuar	Me mbylljen e pasqyrave te vitit 2022	Matilda Hoxha Gazmend Haxhija Marsel Mulla	Pergjegjese e Sektorit te Menaxhimit Financiar Drejtor i Drejtorise se te Ardhurave dhe Licensimit Drejtor i Inspektimit dhe Mbrojtjes se Territorit.

		kontabilitet të llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*", duke e debituar vlerën **16,552,583 lekë** për vitin 2020, për debitorët nga taksat dhe tarifat vendore si dhe nga gjobat e IMT-së. Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për secilin vit përkatës në llogarinë 1210 "*Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit*" të vitit në vazhdim.						
9	9	**Gjetje nga auditimi:**-Nga auditimi rezulton se, për zbritjen e vlerave të projekteve apo shpenzimeve për mbikëqyrje nga gjendja e llog. 202 "*Studime dhe Kërkime*", për investime të kryera në vite të mëparshme dhe që janë kapitalizuar si AQT, duheshin prerë artikuj kontabël për kreditimin e kësaj llogaritje në debi të llogarisë së aktivit përkatës sipas vlerave përkatëse për secilin investim, duke ia shtuar vlerën aktivit. Për rrjedhojë duhej të ishte kredituar llog.202 "*Studime dhe Kërkime*", për **6** studimet dhe projektimet në vlerën **12,281,610 lekë në debi** të llogarisë së aktivit përkatës, klasa e Aktiveve Afatgjata Materiale. -Për këto aktive nuk ka inventar, si dhe nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv. -Nga auditimi i kontratave të lidhura për investimet në Bashkinë Devoll, për vitet 2018, 2019 dhe 2020 rezultuan se, për kontrata punimesh të lidhura nga Bashkia Devoll, projekti është kryer nga operatorë ekonomikë privat si më poshtë: Në marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Bashkisë Devoll dhe shoqërisë "HMK-Consulting" ShPK me nr.1279/3 prot, datë 05.06.2020, nga shoqëria"HMK-Consulting" shpk është kryer dhuratë projekti "*Ndërtim i ujësjellësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Sinicë, Qytezë, Vidohovë, Njësia Administrative Miras*". Ky projekt nuk është bërë hyrje në magazinë dhe të paraqitej te pasqyra e pozicionit financiar me vlerën kontabël të vlerësuar në llog.202 "*Studime dhe Kërkime*". Nga të dhënat e paraqitura konstatohet se në Drejtorinë e	**Ska**	7-109	Pranuar	Per studim projektimet jane kryer te gjitha veprimet gjithashtu eshte bere hyrje edhe projekti per " Ndertimin e Ujesjellesit te jashtem dhe te brendshem per fshatin Sinice,Qyteze ,Vidohove, NjA Miras". Kjo detyre eshte realizuar plotesisht me pasqyrat financiare te vitit 2021 sipas rekomandimit te KLSH.		

		Financës/Buxhetit, nuk është paraqitur akt marrëveshja e dhurimit nr.1279/3 datë 05.06.2020, për rrjedhojë nuk është kryer kontabilizimi i projektit me vlerë kontabël sipas akt marrëveshjes. Kjo situatë tregon mos funksionimin e sektorëve dhe korrespondencës zyrtare midis tyre. Veprimet e mësipërme janënë kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" ; Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 57 **9.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa për regjistrimi në kontabilitet të projekteve të dhuruara në llog202"*Studime dhe Kërkime*", duke u bazuar në dokumentacion shoqërues (*marrëveshja/akti i dhurimit*), si dhe Titullari i Institucionit të autorizojë rivlerësimin e tyre. Nga ana e Sektorit të Financës për projektet të cilat aktivi ka përfunduar të merren masa për kreditimin e kësaj llogaritje në debi të llogarisë së aktivit përkatës sipas vlerave përkatëse për secilin investim, duke ia shtuar vlerën aktivit.						
10	10	**Gjetje nga auditimi:** Bashkia Devoll, për pronat dhe asetet, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës, arsim, shëndetësi, kulturë, sport, monumente historike e kulturore, shërbime publike, infrastrukturë, bujqësi e ushqim, ujësjellës, troje dhe hapësira publike, pyje kullota, të kaluara Bashkisë nga pushteti qendror me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish- Komunave/ Bashkive*", nuk dispononte dokumente shoqërues si: harta me të dhëna mbi	**Ska**	7-109	Pranuar	Ngritja e urdherit menjehere dhe verifikimi, invenarizimi si dhe regjistrimi ne vazhdimesi	Eduard Duro Enida Haxhi Per perpilim urdhri Edmir Cenolli	Kryetari i Bashkise Pergje i sektorit juridik dhe prokurimeve Pergjegjes e

		infrastrukturën, plan vendosjen e sipërfaqen, kufizimet, statusin e tregues të tjerë. Nuk është kryer inventarizimi i këtyre pronave, duke kryer verifikimin në terren të gjendjes reale dhe statusin e tyre nga komisione të posaçme me specialist të fushës. Nuk ka aplikuar në ASHK Dega Devoll për regjistrimin e Aseteve, nuk ka hartuar përmbledhjen dhe bashkimin e listave të Aseteve të Njësive Administrative për të përpiluar në këtë mënyrë një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme të Bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, dhe dokumentimin në pasqyrat financiare të Bashkisë Devoll. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 "Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë"; Kap. VII, neni 23, pika 14 "Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj" , UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme". Kap III- Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në Njësitë e Qeverisjes së përgjithshme, pika 30 **10.1. Rekomandimi**: Kryetari i Bashkisë Devoll të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për verifikimin e gjendjes reale dhe statusin e pronave dhe aseteve të kaluara në pronësi të saj, duke përfshirë dhe Njësitë Administrative, si dhe të kryejë inventarizimin, regjistrimin e të gjitha aseteve në ASHK Dega Devoll, duke përgatitur të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor, më pas vlerësimin, kontabilizimin dhe pasqyrimin në aktivet e qëndrueshme në pasqyrat financiare.						sektorit te pyjeve Specialit ne sek e Kadastres Pergjegjese e Sek twe menaxhimit financiar
11	11	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i analitiku të llog.212 "*Ndërtesa dhe Konstruksione*" në Bashkinë Devoll,	**Ska**	7-109	Pranuar	Ne vazhdimesi	Eduard Duro	Kryetari i Bashkise

		rezulton se për 3 objekte me vlerë **95,795 mijë lekë** dhe analitiku i llog.213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" për 3 objekte me vlerë **572,125 mije lekë**, nuk kanë emërtim, nuk paraqiten kartela inventariale dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Mungesa e analizës për këto objekte të trashëguara nga ish-komunat por të regjistruara në pasqyrat financiare të vitit 2020 në Bashkinë Devoll, ka një ndikim të konsiderueshëm në informacionin kontabël që ofrojnë këto pasqyra në lidhje me pohimet financiare, për rrjedhojë nuk përmbushin kriteret e plotësisë së një aktivi, mos ekzistencën e informacionit kontabël si dhe vërtetësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30 **11.1. Rekomandimi**: Kryetari i Bashkisë Devoll të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 212"*Ndërtesa dhe Konstruksione*" dhe në llog. 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF, si dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.						
12	12	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 020, rezulton se për llogaritë, 210 "*Toka, troje, terrene*", 211 "*Pyje Plantacione*", 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*", 213 "*Rruge, rrjete, vepra ujore*", 214 "*Instalime teknike, makineri e pajisje*", 215 "*Mjete transporti*" dhe aktivet afatshkurtra, nuk ekziston një	**Ska**	7-109	Pranuar	Ne Vazhdimesi	Matilda Hoxha	Pergjegjese e Sektoirit te Menaxhimit Financiar

		regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Amortizimi i llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jo-Materiale është kryer në grup aktivesh sipas llojit dhe jo për çdo aktiv në mënyrë të veçantë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pikat nga 10,12,81,83,85,86 26-30, 74, 96-101, 102 dhe103 **12.1. Rekomandimi**: Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa për të krijuar dhe mbajtur regjistrimin e aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.						
13	13	**Gjetje nga auditimi**: Për vitin ushtrimor 2020 nga Kryetari i Baskisë me urdhrin nr.312 datë 23.10.2020, është ngritur grupi "*Për nxjerrjen jashtë përdorimit të inventarit të imët, instalime teknike, vegla pune, inventar ekonomik*". Urdhri është për daljen jashtë përdorimit dhe shkarkimin nga kontabilitetit për inventarët në shumën 3,705,982 lekë, nga e cili: inventar i imët (llog. 237-1) 2,153,73 lekë, inventar (llog. 214) në shumën 264,628 lekë dhe inventar	**ska**	7-109	Pranuar	Ne vazhdimesi	Matilda Hoxha	Pergjegjese e Sektoirit te Menaxhimit Financiar

		ekonomik (llog. 218) në shumën 1,287,615 lekë . Nga grupet e punës janë hartuar relacionet mbi vlerësimin e inventarëve të Bashkisë Devoll, si dhe janë firmosur nga Nëpunësi Autorizues. Janë hartuar procesverbalet e vlerësimit për materialet të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, të cilat janë miratuar dhe janë me firmën e Titullarit të Bashkisë Devoll. Te përshkrimi i dhënë në relacionet e vlerësimit thuhet që materialet të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi janë të pa përdorshme, kanë humbur cilësitë e tyre të përdorimit në kushtet teknike si dhe nuk mund të riparohen për t'ua rikthyer vlerën, megjithëse nuk u ka kaluar afati vlefshmërisë. Komisioni në këto kushte ka vlerësuar se këto materiale duhet të nxirren jashtë përdorimit nëpërmjet asgjësimit fizik. Nga verifikimi i listës së materialeve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit nëpërmjet asgjësimit fizik, rezulton se ka një pjesë të konsiderueshme të materialeve me profil drusor dhe metalik të cilët duheshin bërë hyrje dhe rishitur me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë, këto për shumën prej 264,628 lekë të shkarkuara nga kontabiliteti (*llog214 "Makineri dhe paisje)*, janë materiale me profil metalik, *(llog.218 "Inventar ekonomik")*, janë materiale me profil drusor *(banka, tavolina, karrige, rafte drusor)* për të cilat duhet të ishin grumbulluar dhe të shiteshin në ankand. Nga ana e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit në proces verbalet e mbajtura nuk paraqiten dokumente mbështetës ku të përshkruhet procedura e ndjekur sipas rastit për çdo aktiv dhe destinacionin përfundimtar të aktiveve *(në ndryshimin e formës fillestare, groposur ose djegur)*, si dhe për materialet me profil druri dhe metalik nuk janë përdorur si materiale të ricikllueshme, të shiteshin në formë ankandi ndërmarrjeve që i grumbullojnë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 10296 "Për menaxhimin financiar						

		dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pikat 104, 109 dhe 110 **13.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Devoll, të marrë masa dhe të nxirren përgjegjësitë për komisionet që kanë kryer nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve me profil drusor dhe metalik duke mos i bërë hyrje në magazinë me qëllim qëmë pas të shiteshin në formë ankandi. **13.2. Rekomandimi:** Grupi i Menaxhimit Strategjik, për vitin ekzistues të hartojë një procedurë të drejtë dhe në përputhje me Udhëzimin nr.30 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik*", i ndryshuar për komisionet që do të ngarkohen për vlerësimin dhe asgjësimin e materialeve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi.						
14	14	**Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi rezultoi se: - Bashkia Devoll nga verifikimi i të dhënave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton se në datën 7.4.1999 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Devoll SHA me NUIS J66702601K, e cila është shoqëri aksionere me objekt "*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij*". Numri i aksioneve është 221,410 lekë/aksion me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej **221,410,000 lekë.** Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Devoll në "Ujësjellës Kanalizime Devoll " SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020, më konkretisht në llog.*26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta".* - Bashkia Devoll nga verifikimi i të dhënave në QKB, rezulton se në datën 5.6.2008 paraqitet si aksionere me 11% të aksioneve te shoqëria "KRËM SHA" me NUIS K84227001O e cila është shoqëri aksionere me objekt "*Mbledhje, transporti, administrimi, depozitimi i mbetjeve bashkiake dhe komunale*".	Ska	7-109	Pranuar	Ne pasqyrat financiare te vitit 2022	Matilda Hoxha	Pergjegjese e Sektoirit te Menaxhimit Financiar

		Numri i aksioneve është 25 me vlerë nominale 16,550 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej **413,750 lekë**. Kjo vlerë e kapitalit me **11%** aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Devoll në shoqërinë "KRËM " SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020,më konkretisht në llog.*26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* Në rastin tonë investimet përbëjnë aksionet me vlerë kontabël (kosto) **221,823,750 lekë** dhe Investitori është Bashkia Devoll. Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime ne pjesëmarrje me vlerë kontabël **221,823,750 lekë** përbën mos pasqyrim të informacionit financiar, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale" pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje" **14.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Devoll, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të "Ujësjellës Kanalizime Devoll" SHA me vlerë kontabël **45,434,140 lekë**, si dhe regjistrimin e pjesëmarrjes me 11% të kapitalit aksionar të "KRËM SHA" me vlerë kontabël **413,750 lekë** në debi të llog. 26 "*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.						
15	15	**Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi rezulton se për objektet të cilat janë në proces investimi dhe nuk janë marrë në dorëzim, nga ana e sektorit të financës janë kapitalizuar tek klasa e aktiveve afatgjata materiale, në vlerën e situacioneve deri në 31.12.2020, veprim është kryer në	**Ska**	7-109	Pranuar	Ne pasqyrat Financiare te vitit 2021 jane jane kontabilizuar te gjitha	Matilda Hoxha	Pergjegjese e Sektoirit te Menaxhimit Financiar

		kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, pika 18. Nga lëvizjet kontabël të llog. 231 "*Investime në proces*" për vitin ushtrimor 2020, rezulton se janë **16** objekte në vlerë kontabël **96,055,495 lekë**. Për këto 16 objekte edhe pse nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Devoll, në pasqyrën e pozicionit financiar ato paraqiten në klasën e aktiveve afatgjata materiale. Këto objekte të pa përfunduara duhet të pasqyroheshin në llog.231 "*Investime në proces*" dhe në momentin e marrjes në dorëzim të kapitalizohen më pas tek klasa e aktiveve afatgjata materiale në vlerën e plotë kontabël të aktivit. Veprime në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu 2 "Klasa 2 Aktivet Afatgjata" Përbërja dhe trajtimi kontabël" **15.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Devoll të bëjë sistemimi në kontabilitet të llog.231 "*Investime në proces*", duke kryer veprimin kontabël në debi të llog.231 për shumën prej **96,055,495 lekë,** të investimeve në proces, në kredi të llogarive në klasën e aktiveve afatgjata materiale. Në momentin e marrjes në dorëzim të aktiveve vlera e plotë e Investimit të kapitalizohet më pas te klasa e Aktiveve Afatgjata Materiale.				faturat ne llogarine 231 "Investime ne proces" Ne vijimesi te procedohet ne zbatim te udhezimit nr.08 date 09.03.2018 i ndryshuar		
16	16	**Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2020, rezulton se në llog.230 "*Investim në proces për aktive afatgjata jo-materiale*" vlera kontabël **8,095,000 lekë** përfaqëson projekte të trashëguara për të cilat nuk ka kartela. Këto projekte të cilat janë të përfunduara pasi janë trashëguar nga ish-komunat duhet të ishin kapitalizuar tek	Ska	7-109	Pranuar	Ne pasqyrat financiare te vitit 2022	Matilda Hoxha	Pergjegjese e Sektoirit te Menaxhimit Financiar

		klasa e aktiveve afatgjata jo-materiale në vlerën e plotë kontabël të aktivit. Mungesa e analizës për këto aktive të trashëguara nga ish-komunat, por të regjistruara në pasqyrat financiare të vitit 2020 në Bashkinë Devoll, ka një ndikim të konsiderueshëm në informacionin kontabël që ofrojnë këto pasqyra në lidhje me pohimet financiare, për rrjedhojë nuk përmbushin kriteret e plotësisë së një aktivi, mos ekzistencën e informacionit kontabël si dhe vërtetësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale U konstatua një klasifikimi gabuar i vlerës së këtyre **projekteve**, të cilat nuk janë kapitalizuar si aktiv te klasa e Aktiveve Afatgjata Jo-Materiale në vlerën kontabël prej **8,095,000 lekë.** Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu 2 "Klasa 2 Aktivet Afatgjata" Përbërja dhe trajtimi kontabël" **16.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkisë Devoll të bëjë sistemimin në kontabilitet tëllog.230 "*Investime në proces*" dhe llog.202 "*Studime dhe kërkime*" me mbylljen e bilancit të vitit pasardhës, për vlerën kontabël prej **8,095,000 lekë** të projekteve të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llog.202 dhe në kredi të llog.230						
17	17	**Gjetje nga auditimi**::Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2020, rezulton se në llog.437,438 "*Organizma të tjerë shtetërore*" vlera kontabël **18,893,310 lekë** përfaqëson një investim të kryer nga ish-komuna Progër sipas kontratës të lidhur nga kjo komunë me shoqërinë "Artyka II" ShPK me nr.2 datë 18.06.2013 me objekt "Rehabilitimi i rrugës së fshatit Cangonj". Vlera e kontratës është 30,762,165 lekë	**Ska**	7-109	Pranuar	Ne pasqyrat financiare te vitit 2022	Matilda Hoxha	Pergjegjese e Sektoirit te Menaxhimit Financiar

		me TVSh, ku deri në vitin 2020 është likujduar vlera 11,778,856 lekë. Nga të dhënat e sektorit të financës rezulton se pjesa tjetër e kontratës nuk është realizuar dhe investimi ka përfunduar me fondet e siguruara nga projekti TAP. Vlera kontabël prej 18,983,310 lekë e cila përfaqëson pjesën e investimit të kryer nga ish-komunat Progër, në vitin ushtrimor të konsolidimit të pasqyrave financiare të Bashkisë Devoll, duhej të kapitalizohej në klasën e aktiveve afatgjata materiale si investim i kryer dhe jo në llog.437 "Organizma të tjerë shtetërorë". Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika nr.18 **17.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Devoll të bëjë sistemimin në kontabilitet të llog.437 -438 "*Organzima të tjerë shtetërorë*" për vlerën kontabël 18,983,310 lekë në debi të klasës së aktiveve afatgjata materiale pasi është investim i marrë në dorëzim.						
18	18	**Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2020, rezulton se Llog. 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 6,362,743 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Nga analiza e kësaj llogarie përbëhet nga 16 objekte nga të cilat për 8 objekte në vlerën prej 3,377,598 lekë, janë fonde që gjenden të ngurtësuara deri në vitin 2018, për të cilat është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhbllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive. Sektori i Financës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të bërë zhbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet.	Ska	7-109	Pranuar	Gjate vitit 2022 te njoftohen subjektet per 5% e viteve te kaluara dhe te sistemohen ne kontabilitet ne zbatim te udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes,	Matilda Hoxha	Pergjegjese e Sektoirit te Menaxhimit Financiar

		Veprime në kundërshtim me ligjin 28/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10" ; ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" seksioni "Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 " Kreditorë për mjete në ruajtje" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 7-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)* **18.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkisë Devoll të marrë masa për të bërë sistemimin e llog. 466 "*Kreditore për mjete nën ruajtje*", duke rakorduar çdo muaj vlerat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilave tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.				paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" , i ndryshuar.		
19	19	**Gjetje nga auditimi**: Nga analizimi i kontratave për investime publike për vitet 2018, 2019 dhe 2020 kemi përpunuar të dhënat, gjendjen e detyrimeve të prapambetura nga shpenzimet kapitale. Nga testimi i saktësisë së llog.486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" si llogari debitore dhe testimin e saktësisë së llog.467 "*Kreditorë të ndryshëm*" si llogari kreditore të regjistrimit në kontabilitet të detyrimeve të prapambetura për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, vendimeve gjyqësore për shkak të mungesës së fondeve. *Detyrimet nga kontratat për investime publike:* 1. Kontrata nr.25 datë 05.12.2019 me objekt "*Rikonstruksion i rrugës Bilisht-Vernik loti I*", e lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe shoqërisë "Artyka II" shpk, me vlerë kontrate 38,746,432 lekë, me burim financimi nga "Donatorë, qeveria Bullgare".	Ska	7-109	Pranuar	Ne pasqyrat Financiare te vitit 2021, ,e gjitha faturat e prera deri ne date 31.12.2021 jane njohur si detyrime ne llogarite perkatese 101,404,467 me kunder parti llogarine 85. **Ne vijimesi te zbatohet me perpikmeri udhëzimi nr.8 datë**	Matilda Hoxha	Pergjegjese e Sektoirit te Menaxhimit Financiar

		Nga auditimi i kontratës, situacioneve dhe faturave për periudhën objekt auditimi rezultoi se: shoqëria "Artyka II" ShPK ka paraqitur 2 fatura në vitin 2020, me vlerë **6,482,261 lekë**, të likujduara në vitin 2021 nga sektori i financës, por nuk janë kontabilizuar në llog.467 "*Kreditorë të ndryshëm*" me kundërparti llog.486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" te pasqyra e pozicionit financiar. **2.**Kontrata nr.4 datë 18.06.2020 me objekt "*Zgjerimi i rrugëve aks superstrada e devollit*", e lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe bashkimit tëOE "Artyka II ShPK" & "Niem ShPK", me vlerë kontrate **99,236,740 lekë**, me burim financimi nga "të ardhurat e Bashkisë". Nga auditimi i kontratës, situacioneve dhe faturave për periudhën objekt auditimi rezultoi se: bashkimi i OE "Artyka II ShPK" & "Niem ShPK" kanë paraqitur 3 fatura tatimore në vitin 2020, me vlerë 6,200,000 lekë, të likujduara në vitin 2021 nga sektori i financës, por nuk janë kontabilizuar në llog.467 "*Kreditorë të ndryshëm*" me kundërparti llog.486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" **3.**Kontrata nr.25 datë 24.11.2020 me objekt "*Burimi i ujësjellësit i fshatit Tren*", e lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe shoqërisë "SPARTAK SA" shpk, me vlerë kontrate **569,311 lekë**, me burim financimi nga "të ardhurat e Bashkisë". Nga auditimi i kontratës, situacioneve dhe faturave për periudhën objekt auditimi rezultoi se: shoqëria "SPARTAK SA" shpk ka paraqitur 1 (një) faturë tatimore në vitin 2020, me vlerë 569,311 lekë, likujduar në vitin 2021 nga sektori i financës, por nuk janë kontabilizuar në llog.467 "*Kreditorë të ndryshëm*" me kundërparti llog.486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" **4.**Kontrata me objekt "*Administrimi i mbetjeve të qarkut Korçë*", e lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe SHA "KRŴM", me pagesa të pritshme vjetore 7,981,705 lekë me TVSh, me burim financimi nga "të ardhurat e				**09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar**		

		Bashkisë". Nga auditimi i kontratës, situacioneve dhe faturave për periudhën objekt auditimi rezultoi se: shoqëria "KRŴM" ka paraqitur fatura tatimore në vitin 2020, me vlerë 4,701,475 lekë, e cila është likujduar në vitin 2020 vlera 2,322,919 nga sektori i financës, por nuk janë kontabilizuar pjesa tjetër e detyrimit në vlerën **2,378,556 lekë** në llog.467 "*Kreditorë të ndryshëm*" me kundërparti llog.486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*". Pra nga testimi i pagesave me bankë dhe i dokumentacionit shoqërues për vitin 2020 dhe vitin 2021, rezultoi se në gjendjet ne bilancin e vitit ushtrimor 2020 nuk është përfshirë shuma prej 15,568,491 lekë. Për vitin ushtrimor 2020, gjendja e llog.467 "*Kreditorë të ndryshëm*" prej 61,489,880 lekë nuk rakordon me vlerën reale të detyrimeve që rrjedhin nga faturat e palikujduara për mallra, shërbime, investime, detyrime nga vendimet gjyqësore të pa paguara dhe detyrimet të pa paguara nga shpronësimet, duke mos u paraqitur në analitikun e llog.467 "*Kreditorë të ndryshëm*", shuma prej **15,568,491 lekë**. Mos kryerja e veprimeve kontabël për këto detyrime e si rrjedhojë mospërfshirjen e vlerës që lindin nga këto detyrime ka sjellë mos evidentimin në kontabilitet të gjendjes reale në fund të vitit ushtrimor 2020, duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real për detyrimet që ka Bashkia ndaj të tretëve. Veprime në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, neni 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" kreu I pika 8,						

		Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32, 42 **19.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Devoll, të marrë masa që të evidentohen detyrimet në pasqyrat financiare duke i njohur në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës së tyre nga llogaritë financiare. **19.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Financë/Buxhet në Bashkinë Devoll, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llog.486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" dhe kundërparti së saj 467 "*Kreditorë të ndryshëm*", për shumën **15,568,491 lekë** për vitin ushtrimor 2020.						
20	20	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i strukturës organizative të Drejtorisë së të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Devoll, rezulton se struktura ka probleme dhe nuk është në përputhje me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, e cila ti shërbejë Bashkisë Devoll në realizmin e të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimi i Sektorit të Masave Shtrënguese si një nga sektorët më të rëndësishëm të Drejtorisë së të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, ku numri i debitorëve është shumë i lartë, gjithsej për vlerën **41,410,030 lekë,** duke e bërë të vështirë zbatimin e procedurave për arkëtimin e debitorëve në zbatim të pikës (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar dhe Kreun XI- "*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*", nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" me ndryshime **20.1. Rekomandimi**: Kryetari i Bashkisë Devoll në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për riorganizimin e Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licensave, duke emëruar drejtorin e kësaj drejtorie (si vend vakant) dhe krijimin Sektorit të Menaxhimit të Borxhit.	**Ska**	52-79	Pranuar	Ne vazhdim	Eduard Duro Adriana Rushitaj	Kryetar i Bashkise Pergjegjese e Burimeve Njerezore

21	21	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi të ardhurat e realizuara për periudhën objekt auditimi (01.01.2018 – 31.12.2021), rezulton se megjithëse të ardhurat nuk janë realizuar në asnjë nga periudhat ushtrimore, nga Bashkia Devoll në planifikimin e të ardhurave evidentohet një rritje e nivelit të tyre, ku për vitin 2018 kjo është me e theksuar, pasi kemi një rritje prej 88% ose në vlerë prej 76,508 mijë lekë. Kjo rritje e paargumentuar, gjë e cila konstatohet dhe nga mos realizmi i të ardhurave në asnjë periudhë ushtrimore të auditimit, bëhet me qëllim që Bashkia Devoll të rrisë artificialisht fondet në buxhetet e viteve respektive për miratimin e shpenzimeve si në paga, shpenzime operative, për investime etj, të cilat në fund të periudhave ushtrimore mbesin të palikujduara si rezultat i mos realizmit të të ardhurave, duke çuar në rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore, ku më 31.12.2021 paraqitet në **vlerën 51 milionë lekë,** veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 64, "*Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë*"; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*" i ndryshuar, neni 5, "*Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore*", neni 42, "*Administrimi i mjeteve monetare*", pika 1, 2 dhe 4; neni 54, "*Raportimi financiar*" nënpika c, Udhëzimi i MFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV "*Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave*" pika 200, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar **21.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licensave Bashkia Devoll, gjatë hartimit të projektit/planit të të ardhurave nga taksat/ tarifat vendore, të planifikojë saktë treguesit e planit mbi baza reale, duke u mbështetur në mundësitë reale të aktivitetit në bashkinë Devoll, në	Ska	52-79	Pranuar	Ne vijimesi	Gazmend Haxhija	Drejtor i Drejtorise se te Ardhurave dhe Licensimit

		mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të të ardhurave, duke respektuar kuotën 10% rritje nga njëri vit në tjetrin.						
22	22	**Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licensave Bashkia Devoll, rezulton se për periudhën objekt auditimi janë mbajtur akt-rakordimet mujore dhe vjetore, por që janë të paplota, pasi në to nuk evidentohet se sa është numri i personave që duhet të paguajnë detyrimin, sa nga këto persona plotësojnë kriteret për pagesa, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe nëse vlera e arkëtuar nga agjentët tatimorë janë likuiduar në afat apo jo, kjo për ASHK *(nga shitja e pasurisë),* Drejtoria e Shërbimit të TransportitRrugorë*(për mjetet qarkullues),* Drejtoria Rajonale Tatimore Devoll *(tatim fitim thjeshtuar)* dhe Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizim sha *(abonentët familjarë).* Bashkia Devoll nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm. Për sa më sipër, Bashkia Devoll nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjellës-Kanalizime. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse. Mos arkëtimet nga ana e ASHK-së janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e	Ska	52-79	Pranuar	Ne vijimesi	Gazmend Haxhija	Drejtor i Drejtorise se te Ardhurave dhe Licensimit

		infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Devoll është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektesh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Devoll duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme. Veprime në kundërshtim me ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore*", me ndryshime, ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "*Për Taksat Kombëtare*", i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, datë 4.4.2017, "*Për Taksat Kombëtare*", etj **22.1. Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Lejeve dhe Licensave Bashkia Devoll, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. **22.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Devoll, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.						
23	23	**Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e proceduarve të prokurimit, rezulton se: a-Për disa procedura projektet/ preventivat janë hartuar nga	**Ska**	52-79	Pranuar	Ne vijimesi	Eduard Duro	Kryetar i Bashkise

		specialistët e Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit, Bashkia Devoll dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë Devoll, por të papajisur me licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë, si: *1- Procedura me objekt:"Rehabilitim i rrugëve të qytetit Bilishti 2", viti 2021 me fond limit 71,416,666 lekë.* *2- Procedura me objekt:"Përmirësim i banesave ekzistues për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara", viti 2019 me fond limit 16,773,145 lekë.* b- Dosjet e procedurave të prokurimit edhe pse ishin mbyllur në të gjitha fazat e tij, nuk ishin të inventarizuara dhe protokolluara në arkivën e Bashkisë Devoll. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 13 dhe 29 "*Përgjegjësitë e Kryetarit të Bashkisë*", neni 22 "*Plani i detajuar vendor*", neni 37 "*Kushtet për zhvillim*", neni 38 "*Leja e zhvillimit*"; neni 39 "*Leja e ndërtimit*", VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit, kreu III, neni 5 dhe neni 6, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar; VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", e cila ka miratuar Rregulloren "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", neni 16 "Licenca –kategoritë e punimeve". Ligji nr. 9154, datë 6/11/2003 "Për Arkivat"; nenin 4/26 **23.1.Rekomandimi**: Bashkia Devoll të marrë masa për					Esjona Meka Roland Hysolli Eriksela Avdo	Specialist inxh.ndertimi Specialist inxh..ndertimi Specilaist prokurimesh

		kryerjen e projekteve nga persona/subjekte të përcaktuar nga ligji, në mënyrë që projektet të jenë sa më cilësorë dhe që paraqesin gjendjen reale të objektit. **23.2.Rekomandimi**: Sektori i Procedurave të Prokurimit Bashkia Devoll, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2021 me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor.						
24	24	**Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave të prokurimit për blere karburanti për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2021, u konstatua se sasia e përcaktuar për blerje dhe fondi limit përkatës nuk është llogaritur në përputhje me dispozitat ligjore, pasi: Vlera e karburantit e përllogaritur dhe programuar për tu prokuruar nuk është e argumentuar me analizë të hollësishme referuar mbi; sasinë e karburantit gazoil/benzinë gjendje në magazinë, analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (*motogjenerator, kaldaja, etj*) në qarkullim, sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit, etj. Përsa i përket vlerës së përllogaritur për naftë dhe benzinë nuk është evidentuar çmimi i parashikuar, ndërsa nuk është analizuar e krahasuar në përllogaritje edhe çmimi i kontratës së realizuar. Veprime në kundërshtim me neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga VKM nr. 914, datë 27.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, Kreu II "*Rregullat e Përgjithshme të prokurimit*" neni 9 "*Llogaritja e vlerës së*	Ska	52-79	Pranuar	Ne vijimesi	Eduard Duro	Kryetari i Bashkise

		kontratës" **24.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Devoll të marrë masa për ngritjen e një strukture të veçantë për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në vitin paraardhës, sasi e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak.				Ngritja e nje urdhri pune per komisionin		
25	25	**Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit në Bashkinë Devoll mbi zbatimin e aktmarrëveshjes nr. 1359, datë 16.4.2019 të lidhur midis Bashkisë Devoll dhe shoqërisë "*AUTOVISION AL* " shpk, *rezulton se:* Nga komuniteti i NJA Miras Devoll është paraqitur ankesë në Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Dega Korçë. Në të ankesës me shkresën nr. 122, datë 07.11.2018 IKMT Bashkia Korçë i është drejtuar IMT Bashkia Devoll që mbështetur në nenet 4 dhe 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" , të bëhet verifikimi i ankesës, mbi punimet që po kryhen për ndërtimin e Hidrocentralit në Qytezë, sipas të cilave ka sjellë dëmtim të rrugëve dhe ndryshim në mjedis. Me shkresën nr. 3321/1, datë 16.11.2018, Bashkia Devoll *(të cikuar nga Zv. Kryetari z. Sokol Hoxha, mungesë dhe porosi)* ka informuar IKMT Bashkia Korçë mbi verifikimin e shkresës së saj nr. 122/, datë 7.11.2018, ku ndër të tjera thuhet se: *"Bashkia Devoll ka ngritur grupin e punës me përfaqësues të disa sektorëve dhe ka kryer inspektimin në terren, ku ka dalë me vendim nr. 29, datë 14.11.2018 mbi bazën e të cilit nga Policia Bashkiake është mbajtur procesverbal datë 14.11.2018, për pezullimin e punimeve deri në paraqitjen e plotë të dokumentacionit pranë zyrave të Bashkisë Devoll(bashkëlidhur Raport Auditimit gjendet procesverbali).*	Ska	173-175	Pranuar	Te ngihet grup pune	Roland Hysolli Aurela Furxhi	

		Në procesverbalin e datës 14.11.2018 të mbajtur nga Policia Bashkiake, thuhet se: *"Në zbatim të vendimit nr. 29, datë 14.11.2018 për inspektimin në subjektin "Muso HC Qytezë", i cili kryhen punime në aksin e lartpërmendur, u konstatua disa punëtorë dhe ju interpretuan parregullsi të cilat janë konstatuar nga sektorët përkatës nga Bashkia Devoll....* Nga auditimi më tej i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se ndërmjet institucionit Bashkia Devoll përfaqësuar nga z. Bledjon Nallbati dhe shoqërisë "AUTOVISION AL", është lidhur aktmarrëveshje nr. 1359, datë 16.4.2019 (*noterizuar me nr. 670, datë 16.04.2019)* me objekt:						
		1- ".....financimi nga shoqëria "AUTOVISION AL" ShPK i materialeve të ndërtimit dhe karburanti që do të përdorin mjetet për ndërtimin për ndërtimin e rrjetit të jashtëm për furnizimin e ujësjellësit të fshatit Miras nga burimi i valës të Sinicës, sipas projektit të hartuar për këtë qëllim në përputhje me specifikimet teknike të tij, të miratuara nga Bashkia Devoll" *2- Zbatimi i këtij projekti do të vlerësohet si investim në komunitet i shoqërisë "AUTOVISION AL" shpk, e cila aktualisht është shoqëri koncesionare dhe po ndërton në territorin e Bashkisë Devoll HEC Qytezë.*						
		Nga ana e Bashkisë Devoll, zyra e Planifikim Zhvillimit Territorit përfaqësuar nga ing. Roland Hysolli është hartuar preventivit i punimeve për ujësjellësin e Mirasit për vlerën 17,930,380 lekë, ku vlera e bazës materiale paraqitet në shumën 9,877,823 lekë. Sipas nenit 7 të aktmarrëveshjes shoqëria "AUTOVIZION –AL" shpk, duhet që brenda 14 ditëve të dorëzonte në Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizime SHA Devoll mostrat e materialeve për miratim dhe brenda një jave do të sigurojë furnizimin, duke dorëzuar materialet me procesverbal dorëzimi të detajuar sipas preventivit. Nga ana e shoqërisë nuk është bërë i mundur respektimi i afateve të përcaktuara në këtë aktmarrëveshje për						

		dorëzimin e materialeve, kjo për arsye të ndryshme. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga magazina e "Ujësjellës Kanalizime Devoll" sha, e përfaqësuar nga z. Mariol Miza, rezulton se nga shoqëria janë dorëzuar këto materiale: *a- Sipas FD nr. 1006, datë 25.4.2019 mostrat e materialeve;* *b- Sipas PV nr. 157, datë 6.6.2019 dhe në zbatim të akt-marrëveshjes është bërë dorëzimi i një sasi materiali "Tubo ujësjellësi PERC100Dj = 110 mm, PN 10, 2500 ml.* Pra nga të dhënat e magazinës nuk ka asnjë sasi tjetër materiali të dozuar në "Ujësjellës Kanalizime Devoll" SHA, sipas projektit të hartuar nga Bashkia dhe rënë dakort me shoqërinë "*AUTOVISION AL*" shpk, e konkretizuat në aktmarrëveshjen nr. 1359, datë 16.04.2019. Nga sa trajtuar më sipër, rezulton se aktmarrëveshjen nr. 1359, datë 16.04.2019 e lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe shoqërisë "*AUTOVISION AL*' shpk, nuk është zbatuar e plotë, referuar qëllmi të sajë për të cilën është hartuar dhe nënshkruar nga palët. **25.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Devoll të ngrejë një grup pune me specialist të fushës dhe të analizojë shkaqet dhe rrethanat e mos zbatimit të aktmarrëveshjen nr. 1359, datë 16.4.2019 të lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe shoqërisë "*AUTOVISION AL*' shpk, me objekt: *...financimi nga shoqëria "AUTOVISION AL" ShPK i materialeve të ndërtimit dhe karburanti që do të përdorin mjetet për ndërtimin e rrjetit të jashtëm për furnizimin e ujësjellësit të fshatit Miras nga burimi i valës të Sinicës, sipas projektit të hartuar për këtë qëllim në përputhje me specifikimet teknike të tij, të miratuara nga Bashkia Devoll,* duke konkluduar mbi këtë aktmarrëveshje dhe nxjerrjen e përgjegjësive.						

B: MASA PER SHPERBLIM DEMI								
1	1	**Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Zgjerimi i rrugës vendore, aks Superstrada e Devollit – Ismail Qemali, Demir Progri –Aks rruga Ethem Osman Xhaci dhe rehabilitimi i rrugëve vendore, Lagjja nr.2 dhe "Lagjja nr. 3", Bashkia Devoll,* me vlerë të kontratës (me TVSh) 99,236,740 lekë, fituar nga bashkimi i OE "NIEM" SHPK & "ARTYKA II" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 389,200 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1463 prot datë 16.06.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll dhe BOE "NIEM" SHPK & "ARTYKA II" SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.6 faqe 170-179të Raportit Përfundimtar të Auditimit).* **1.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financë/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Devoll të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **389,200 lekë pa TVSh** nga bashkimi i OE "NIEM" SHPK & "ARTYKA II" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1463 prot datë 16.06.2020, me objekt "Zgjerimi i rrugës vendore, aks Superstrada e Devollit – Ismail Qemali, Demir Progri –Aks rruga Ethem Osman Xhaci dhe rehabilitimi i rrugëve vendore, Lagjja nr.2 dhe "Lagjja nr. 3", Bashkia Devoll, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.	**389,200**	170-179	Pranuar	Brenda dates 30.07.2022 Sektori i Menaxhimit financiar te kontabilizoje vleren te njoftoje subjektin perkatesisht 233,520 leke operatorit ekonomik NIEM shpk dhe 155,680 operatori ekonomik Artyka II. Sektori juridik te vijoje procedurat me pas nese subjekti nuk arketon shumat.	Matilda Hoxha Enida Haxhi	Pergjegjese e Sektorit te Menaxhimit Financiar Pergjegjese e zyres juridike, prokurimeve
2	2	**Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rehabilitimi i rrugëve në Bashkinë Devoll, Loti I, Rehabilitimi i rrugëve të qytetit Bilisht", Bashkia Devoll,* me vlerë të kontratës (me TVSh)41,999,663 lekë, fituar nga OE "NIEM" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në	**330,000**	112-113	Pranuar	Brenda dates 30.07.2022 Sektori i Menaxhimit financiar te kontabilizoje vleren te	Matilda Hoxha	Pergjegjese e Sektorit te Menaxhimit Financiar

		vlerën 330,000 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3028 prot datë 28.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll dhe OE "NIEM" SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.6 faqe 170-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).* **2.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financë/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Devoll të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **330,000lekë pa TVSh** nga OE "NIEM" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3028 prot datë 28.12.2018, me objekt "Rehabilitimi i rrugëve në Bashkinë Devoll, Loti I, Rehabilitimi i rrugëve të qytetit Bilisht", Bashkia Devoll, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.				njoftoje subjektin perkatesisht 330.000 leke operatorit ekonomik NIEM shpk. Sektori juridik te vijoje procedurat me pas nese subjekti nuk arketon shumat.	Enida Haxhi	Pergjegjese e zyres juridike, prokurimeve
3	3	**Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rehabilitimi i rrugëve në Bashkinë Devoll, Loti II, Rehabilitimi i Rrugëve në NjA Miras", Bashkia Devoll,* me vlerë të kontratës (me TVSh)29,396,869 lekë, fituar nga OE "ARTYKA II" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 224,000 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3028 prot datë 28.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll dhe OE "ARTYKA II" SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.6 faqe 170-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).* **3.1. Rekomandim:** Drejtoria e Financë/Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Devoll të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **224,000lekë pa TVSh** nga OE "ARTYKA II" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3028 prot datë 28.12.2018, me objekt "Rehabilitimi i rrugëve në Bashkinë Devoll, Loti II, Rehabilitimi i Rrugëve në NjA	**224.000**	108-109	Pranuar	Brenda dates 30.07.2022 Sektori i Menaxhimit financiar te kontabilizoje vleren te njoftoje subjektin perkatesisht 224.000 leke operatorit ekonomik Artyka II shpk. Sektori juridik te vijoje procedurat me pas nese subjekti nuk arketon shumat	Matilda Hoxha Enida Haxhi	Pergjegjese e Sektorit te Menaxhimit Financiar Pergjegjese e zyres juridike, prokurimeve

		Miras", Bashkia Devoll, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.						
4	4	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës me objekti *"Shërbimi i pastrimit Bashkia Devoll"* me fond limit 48,826,042 lekë me afat 3 vjeçar, ku fitues është shpallur bashkimi i OE "Alko Impex Construksion" + "Alko Impex General Construcion" ShPK, me vlerë kontrate 48,607,640 lekë, rezulton se në zbatimin në fakt të kontratës numri i punonjësve në terren nuk është i njëjtë me numrin e punonjësve sipas llogaritjes së fondit limit (31 punonjës), dhe të kërkuara në DST (50 punonjës), pasi ky shërbim kryhej për 27 punonjës. Si rezultat Bashkia Devoll, gjatë fazës së zbatimit të kontratës duhet të bëhet rivlerësim i vlerës së kontratave vjetore për tre vite në **3,491,664 lekë**, për një përdorim me efektiv dhe efiçensë të fondit të prokuruar, kjo në raport me numrin e punonjësve në fakt për zbatimin e kontratës, duke e bërë zbritje nga vlera e kontratës fillestare të lidhur në fillim, pasi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se nga Bashkia Devoll nuk është hartuar plan vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve në territorin që ka nën juridiksion, nuk është marrë asnjë masë për grumbullimin e mbetjeve në mënyre të diferencuar, nuk bëhet menaxhimi i mbetjeve referuar piramidës së menaxhimit të mbetjeve (*parandalim, riciklimi, ripërdorim*), veprime këto në kundërshtim me nenet 10, 12, 14 dhe 18 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Në dosjen e zbatimit të kontratës të paraqitur nga mbikëqyrësi i punimeve z. Florenc Zylfi, është në	**3,491,664**	107-170	Pranuar	Gjatë fazës së zbatimit të kontratës së shërbimit të pastrimit	Eduard Duro Gentian Keco	Kryetari i Bashkise Drejtor i Agjencise te Sherbimeve Publike

		kundërshtim me kontratën dhe specifikimet teknike të paraqitura në DST, pasi mungonte dokumentacioni si vijon: - *Planet e punës dhe grafikët e punimeve të miratuara nga AJ;* - *Grafikët duhet të përgatiten nga OE dhe të miratohen çdo vit nga AK Bashkia Devoll. Grafikët mund të pësojnë ndryshime pasi të jenë miratuar nga AK, të cilat janë si vijon:* *1. Oraret e punimit në secilin rrugë dhe trotuar.* *2. Numrin e punëtorëve që do të punojë në çdo operacion punimesh.* - *Dokumentacioni/ gjurmë auditimi për praninë e përfaqësuesit të OE të shërbimit në "Zyrën të kontaktimit" për marrjen e ankesave. Nuk ka asnjë ankesë/ vërejtje nga qytetarët nga qytetarët për pastrimin e bashkisë.* - *Listë prezencë për çdo ditë pune nga OE i shërbimit që detyrimisht duhet të ketë në çdo ditë në punë, minimalisht numrin e punonjësve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e prokurimit për të garantuar kryerjen në kohë dhe me cilësi të shërbimit,* - *Nuk evidentohen PV të mbajtura nga mbikëqyrësit i punimeve ku të pasqyrohet inspektim e realizmit të shërbimit në çdo kohë apo në përfundimin e kryerjes së shërbimit të kontratës, respektimin e standardeve, rregullative dhe cilësinë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mos përmbushje e kontratës.* Kështu referuar relacionit për hartimin e fondit limit në vlerën prej 48,607,640 lekë nga komisioni i Bashkisë Devoll, është parashikuar se për kryerjen e këtij shërbimi nevojiten 31 punëtorë (16 pastruese + 15 shofere),me një fund pagash për 2 vite të kontratës në shumën prej 27,489,852 lekë, *nga të cilat*: vlera 20,837,952 lekë për fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore, ku për 2 vite për 16 punonjësit e pastrimit dhe 15 punonjës shofer duhet						

		vlera prej 6,651,900 lekë. Nga përllogaritjet e bëra rezulton se kosto mesatare sipas përcaktimeve që janë bërë në relacionin e hartimit të fondit limit për 1 (një) punonjës pastrimi për 2 vite të kontratës është 1,302,372 lekë dhe për 1 (një) punonjës shofer 443,460 lekë. Gjithsej vlera mesatare për 1 (një) punonjës (1,302,372 lekë + 443,460 lekë) / 2 = 872,916 lekë (për 2 vitet e kontratës). Sipas dokumentacionit në dosje të paraqitur në momentin e zbatimit të kontratës në terren evidentohet se shoqëria deklarohen gjithsej 27 punonjës ose më pak se numri i përcaktuar në fondin limit prej 4 punonjësish (31-27) dhe shumë herë më pak se numër i punonjësve të kërkuar në DST prej 28 punonjësish (55 -27). Nisur nga kosto mesatare për 1 (një) punonjës të përcaktuar në relacionin për fondin limit, rezulton se për 27 punonjës të deklaruar kosto totale për fondin e pagave do të duhej të ishte 23,568,732 lekë (27 punonjës x 872,916 lekë), ose më pak se fondi i përcaktuar për realizmin e kontratës për vlerën 3,491,664 lekë (27,489,852 lekë – 23,568,732 lekë). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10463, datë 22.9.2021 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" nenet 10, 12, 14, 18 dhe 21, si dhe VKM nr. 319, datë 315.2018 "*Për miratimin e masave për koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve*", **shtojca 1.7** "*Ekzistenca e planit vendorë të menaxhimit të mbetjeve është vendimtar para fillimit të llogaritjes së kostove, pasi ai do të sigurojë shumicën e informacionit teknik dhe infrastrukturor të nevojshëm për variablat e sistemit" (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 107-170të Raportit Përfundimtar të Auditimit).* **4.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Devoll, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për monitorimin e kontratës dhe në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Punimeve për verifikimin e punëve të kryera në terren nga						

